



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: N.T.SH. “ **Ramadani** “ – Mitrovicë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **09.02.2023**, merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: N.T.SH. “ **Ramadani** “ – Mitrovicë , në procedurën e prokurimit me titull: **Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt , Nr.i prokurimit: VU644 – 22 – 8608 – 5-2-1 e Nr. i brendshëm: VU644-22-110-521**
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. **25.01.2023**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ri-ekzaminimit, ri-vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës : **OE.: “ Adnan Bislimi B.I. “ me seli në Skenderaj, ndërsa, O.E.: NTSH “ Ramadani “ (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të eliminuar, bazuar në procedurën e zbatuar.**

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **25.01.2023**, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se, duke vendosur si në Vendimin e dt. 25.01.2023, A.K. ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenin 68 – Gjendja ekonomike financiare dhe nenin 69 – Aftësia teknike dhe / ose profesionale e O.E.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dh krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 25.01.2023 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë

- procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit, konform nenit 10 dhe 11 të LPP-së.
3. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës : OE.: “ **Adnan Bislimi B.I.** “ me seli në Skenderaj është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
 4. Më tej, lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk është dashur të jetë palë në këtë proces për arsye se nuk ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në Njoftimin mbi Vendimin e A.K. të dt. 25.10.2022 , A.K. vlerëson këtë pretendim si të pasaktë sepse, sikurse vlerëson A.K., O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës i përmbushë kërkesat që të jetë “ Palë e interesuar “ sipas nenin 4 paragrafi 1 pika 1.27 e LPP-së, edhe për faktin se ka qenë O.E. i përgjegjshëm por i pasuksesshëm sipas Njoftimit mbi Vendimin e A.K. të dt. 25.10.2022 dhe se në çfarëdo rrethane O.E. mundë të dëshmoi interesin material të tij nga rezultati i aktivitetit të prokurimit në fjalë.
 5. Po ashtu, pretendimi i Ankuesit se O.E. “ Adnan Bislimi B.I. “ nuk i ka përmbushur Kërkesat e saktësuar në Seksionin II. Fleta e Të Dhënave të Tenderit (FTD) të Dosjes së Tenderit, Kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe / ose profesional, neni 9.1 lidhur me 9.2, pika 4 “ për pajisjen finisher nuk ka të dhëna përveç faturës, se qfar pajisje është dhe cilat janë kapacitetet e saja “ A.K. vlerëson këtë pretendim si jo në pajtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-së, sepse nga O.E. nuk është kërkuar që të kenë në dispozicion pajisjen “ finisher “ dhe po ashtu nuk është kërkuar që të dorëzojnë ndonjë dëshmi lidhur me këtë pajisje.
 6. Lidhur me pretendimin se mungesa e pajisjeve të saktësuar në Letrën tenderuese të O.E. , si: Bagerin min. 20-30 ton , Eskavtorin min. 12-16 ton dhe min. 3 (tre) kamion për bartje të materialit min. 10m³, paraqesin devijime të vogla, sikurse keni thkesuar , citat : „ në kuadër të margjinave të lejuaa të LPP-së dhe të njejtat nuk përbëjnë asnjë problem në zbatimin e kontratës „ mbarim citati , sikurse vlerëson A.K. konstatimi është i pasaktë sepse mungesa e dorëzimit në dosjen e tenderit të dëshmimeve për pajisjet e kërkuara paraqet largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit për arsye se :
 - Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe dhe specifikimet e dosjes së tenderit;
 - Afektojnë cilësinë ose ekzekutimin e kontratës;
 - Kufizojnë të drejtat e A.K. dhe / ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës dhe
 - Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat, dhe si të tilla këto mangësi e bëjnë tenderin e Juaj të papërgjegjshëm.
 7. A.K. vlerëson se duke marrë këtë vendim ka pasur parasysh dhe mbrojtjen e parimit “ VLERA PËR PARANË “ , duke vlerësuar dhe respektuar fillimisht dispozitat ligjore lidhur me procesin e Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të tenderëve duke marrë për bazë dhe transparencën, Trajtimin e barabartë të O.E. dhe jo-diskriminim në mes të O.E. duke përfunduar me zbatimin e parimit të “ vlera për paranë “ i cili në fakt është parim shumë i rëndësishëm për buxhetin e A.K. dhe të cilin sigurisht se A.K. e ka pasur në konsideratë.
 8. Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit si ai i dt. 25.01.2023 për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: “ **Adnan Bislimi B.I.** “ me seli në Skenderaj, nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 – Qëllimi, neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesë për rishqyrtim, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik :


Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur dispozitat e LPP-së apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni Ankesë pranë OSHP-së (Organit Shqyrtues për Prokurim Publik) , në bazë të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 110/2022 - datë 09/02/2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkiviti (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik


Azize Krasniqi, u.d. e ZPP-së